

Ligji Nr. 04/L-155 PËR SISTEMIN E PAGESAVE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR SISTEMIN E PAGESAVE

**PJESA I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**KREU I
FUSHËVEPRIMI DHE PËRKUFIZIMET**

**Neni 1
Fushëveprimi**

1. Në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Banka Qendrore është autoriteti i vetëm përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të pagesave të Republikës së Kosovës, me qëllim të garantimit të sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të tij.

2. Më qëllim të rregullimit të sistemit të pagesave ky ligj përcakton:

2.1 .rregullat sipas të cilave autorizohen institucionet e pagesave që ofrojnë shërbime të pagesave dhe licencohen operatorët e sistemeve të pagesave, kliringut dhe shlyerjes së letrave më vlerë nga Banka Qendrore;

2.2. kushtet dhe standardet sipas të cilave mund të ofrohen shërbimet e tilla dhe mund të funksionojnë sistemet e pagesave, kliringut dhe shlyerjes së pagesave, dhe

2.3. mjetet dhe procedurat sipas të cilave Banka Qendrore i ushtron kompetencat e saja mbikëqyrëse.

3. Për aq sa këto mund të ndikojnë në të drejtat dhe obligimet e palëve përkatëse dhe palëve të treta dhe pa paragjykuar në ndonjë kompetencë tjetër të Bankës Qendrore sipas ndonjë ligji të Republikës së Kosovës, ky ligj përcakton rregullat për ekzekutimin e transaksioneve të pagesave dhe zbatimin e marrëveshjeve të kliringut dhe shlyerjes, duke përfshirë edhe rastin e falimentimit të ndonjë pjesëmarrësi në sistem.

**Neni 2
Përkufizimet**

1. Në këtë ligj, përveç nëse kërkohet ndryshe sipas kontekstit, shprehjet e përdorura kanë këtë kuptim:

1.1. **Agjent** - person që vepron në emër të bankave ose të institucioneve tjera të pagesave për ofrimin e disa prej shërbimeve të tyre.

1.2. **Bankë Qendrore** - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

1.3. **Pala qendrore** - një entitet që ndërmjetëson në mes të pjesëmarrësve të sistemit dhe vepron si një palë e tretë e këtyre pjesëmarrësve të sistemit në lidhje me urdhrat e tyre të transferimit.

1.4. **Mbajtësi qendror i letrave më vlerë** - entiteti në regjistrin e të cilit mbahen letrat më vlerë apo instrumentet tjera financiare të cilat mundësojnë që transaksionet e tyre të procesohen përfundimisht në të dhënat në libër.

1.5. **Kliring** - procesi i bartjes, barazimit dhe/ose konfirmimit të instruksioneve për transfer të fondeve apo të letrave më vlerë para shlyerjes dhe përfshin netimin e udhëzimeve dhe krijimin e pozicioneve përfundimtare për shlyerje.

1.6. **Shtëpi e kliringut** - një entitet që ka për detyrë të kalkulojë pozicionet neto të pjesëmarrësve të sistemit, një palë qendrore të mundshme dhe/ose një agjent shlyerjeje të mundshëm.

1.7. **Sistem i kliringut** - një varg procedurash më anë të së cilave institucionet financiare paraqesin dhe shkëmbejnë informacione në lidhje me transferin e fondeve, letrave me vlerë apo të instrumenteve tjera financiare me institucionet tjera financiare nëpërmjet një sistemi të centralizuar apo në një lokacion të vetëm dhe përfshin mekanizmat për llogaritjen e pozicioneve të pjesëmarrësve në sistem në baza bilaterale dhe multilaterale më synim të lehtësimit të shlyerjes së obligimeve të tyre.

1.8. **Kolateral** - të gjitha pasuritë e realizueshme të lëna peng, një marrëveshje për riblerje ose marrëveshje të ngjashme, ose ndryshe, për qëllim të sigurimit të të drejtave dhe obligimeve të mundshme që arrihen në lidhje me sistemin, ose që i janë dhënë Bankës Qendrore.

1.9. **Para elektronike** - vlera monetare e ruajtur në formë elektronike, duke përfshirë edhe formën magnetike, siç paraqitet nga kërkesa ndaj emetuesit, që emetohet pas pranimin të fondeve me qëllim të kryerjes së transaksioneve të pagesave dhe e cila pranohet si mjet i pagesës nga personat tjerë përveç emetuesit.

1.10. **Institucione financiare** - subjekte si banka, zyra të këmbimit valutor, kompani të sigurimeve, fonde pensionale si dhe subjekte të tjera që ushtrojnë aktivitete financiare, siç përcaktohet në ligje përkatëse për qëllimet e këtij ligji, për të cilat Bankës Qendrore i është dhënë autoritet mbikëqyrës me ligj.

1.11. **Procedurë e falimentimit** - çdo masë kolektive e paraparë me ligjin në fuqi, ose për të përmbyllur aktivitetet e pjesëmarrësit në sistem ose për ta riorganizuar atë, qoftë në mënyrë vullnetare ose jo vullnetare, apo për të pezulluar biznesin e tij, duke përfshirë procedurën e falimentimit kur një masë e tillë përfshin suspendimin apo vendosjen e kufizimeve në urdhërpagesa dhe pagesa.

1.12. **Remitancë e parave** - një shërbim i pagesave ku fondet pranohen nga një pagues, pa krijuar ndonjë llogari në emër të paguesit apo të të paguarit, më qëllim të vetëm të transferit të shumës përkatëse tek i paguari apo në një institucion tjetër të pagesave që vepron në emër të të paguarit dhe/ose kur fondet e tilla pranohen në emër të të paguarit dhe vihen në dispozicion të tij.

1.13. **Sistem i pagesave të Republikës së Kosovës** - sistemi kombëtar i pagesave si tërësi dhe përfshin çdo sistem të pagesave, transfereve, sistem të shlyerjes së letrave më

vlerë, sistem të kliringut dhe çdo aranzhim të shfrytëzuar gjatë procesit të kryerjes së transaksioneve të pagesave.

1.14. **Netimi** - përcaktimi i obligimeve neto të pagesave ose përcaktimin e vlerës përfundimtare neto të obligimeve të shlyerjes në mes të dy e më shumë pjesëmarrësve të sistemit në kuadër të këtij sistemi.

1.15. **Marrëveshje e netimit** - një marrëveshje me shkrim për kthimin e disa kërkesave dhe obligimeve në një kërkesë apo obligim të vetëm neto dhe përfshin netimin dypalësh, shumëpalësh, netimin detyrime, netimin përmbyllës, netimin e pagesave apo kombinimin e ndonjërit prej këtyre.

1.16. **Netimi përmbyllës** - marrëveshjen e netimit sipas të cilës pas ndodhjes së ngjarjeve të caktuara nga palët në marrëveshje, të gjitha apo ndonjë nga transaksionet e referuara në marrëveshjen e netimit mund të përmbyllen, dhe në rast të përmbylljes në këtë mënyrë, shuma e përmbylljes bëhet detyrim dhe e pagueshme.

1.17. **Netimi me detyrime** - një marrëveshje netimi ndërmjet palëve për një seri të transaksioneve, ku mbahet një llogari e detyrimeve në të cilën të gjitha obligimet dhe të drejtat e palëve lidhur me llogarinë në vazhdimësi shuhen dhe zëvendësohen me një shumë të vetme të pagueshme nga njëra pale për tjetrën.

1.18. **Mbikëqyrje** - autoriteti i Bankës Qendrore për të rregulluar, vendosur standarde, autorizuar, licencuar, regjistruar dhe monitoruar nëpërmjet inspektimeve të jashtme dhe atyre në vend shërbimet dhe sistemet e pagesave, kliringut dhe shlyerjes së letrave më vlerë që operojnë në Republikën e Kosovës, sipas rastit specifik, që për objekt ka zhvillimin e një sistemi kombëtar efikas, të besueshëm dhe të sigurt të pagesave, kontrollin e rrezikut, mbrojtjen e klientëve, integrimin dhe ndërveprimin e sistemeve dhe kushtet konkurruese të tregut.

1.19. **Institucion i pagesave** - banka ose institucioni financiar të cilit i është dhënë autorizim nga Banka Qendrore në përputhje me këtë ligj për të ofruar shërbime të pagesave.

1.20. **Instrument i pagesave** - çdo instrument ose proces që ia mundëson poseduesit (shfrytëzuesit) lëshimin e një urdhërpagese, duke përfshirë kartelën, pajisjen materiale apo jo materiale ose ndonjë mjet tjetër për qasje në llogari apo sistem të pagesave. Termi nuk përfshinë kartelat apo pajisjet e lëshuara nga tregtarët vetëm për përdorim në dyqanin apo në rrjetin e dyqaneve të tyre.

1.21. **Urdhërpagesë** - çdo udhëzim nga paguesi apo i paguari dhënë institucionit të tij ose të saj të pagesave ku kërkohet ekzekutimi i transaksionit të pagesave.

1.22. **Shërbim i pagesave** - çdo aktivitet, individual ose i përbashkët që mundëson ekzekutimin e transaksioneve të pagesave, duke përfshirë emetimin dhe menaxhimin e instrumenteve të pagesave, ato aktivitete që mundësojnë depozitimet dhe tërheqjen e parasë së gatshme, dhe çdo shërbim tjetër funksional që ndërlidhet më këtë. Ky term nuk përfshin vetëm ofrimin e shërbimeve "on line" apo të telekomunikimit.

1.23. **Përdorues i shërbimit të pagesave** - person fizik ose person juridik që shfrytëzon shërbimin e pagesave në cilësi të paguesit apo të të paguarit, apo të dyja bashkë.

1.24. **Sistem i pagesave** - sistemi ku dy ose më tepër pjesëmarrës bashkëpunojnë në mundësimin e kryerjes së pagesave apo lehtësimin e qarkullimit të parasë, dhe përfshin çdo marrëveshje dhe/apo procedurë për procesimin, shkëmbimin, kliringut, strukturimin dhe/apo shlyerjen e transaksioneve të pagesave. Ky term përfshin këmbimet në instrumentet e pagesave.

1.25. **Transaksion i pagesave** - një veprim, i iniciuar nga paguesi ose i paguari, për vendosjen, transferin apo tërheqjen e parave, pavarësisht nga ndonjë obligim përkatës ndërmjet paguesit dhe të paguarit.

1.26. **Agjent i shlyerjes** - subjekti që iu ofron pjesëmarrësve në sistem dhe/apo ndonjë pale tjetër qendrore që merr pjesë në sistem, llogaritë e shlyerjes më anë të së cilave shlyhen urdhrat për transfer dhe, sipas rastit, iu ofron kredi atyre pjesëmarrësve të sistemit apo palës tjetër qendrore për qëllime të shlyerjes.

1.27. **Rregulla të shlyerjes** - rregullat e përcaktuara që ofrojnë bazën sipas së cilës llogaritën detyrimet e pagesave, neto apo të shlyera dhe përfshijnë rregullat për ndërmarrje të veprimeve në rast se një pjesëmarrës në sistem nuk është në gjendje apo ka gjasë që të mos jetë në gjendje t'i plotësojë obligimet e tij ndaj një shtëpie të kliringut, pale tjetër qendrore apo pjesëmarrësve tjerë në sistem.

1.28. **Shlyerje** - akti i shlyerjes së obligimeve me anë të transferit të fondeve, letrave më vlerë apo të instrumenteve tjera financiare ndërmjet dy ose më tepër palëve.

1.29. **Sistemi i shlyerjes së letrave më vlerë** - sistemi që mundëson kliringun, depozitimim dhe/apo shlyerjen e letrave më vlerë apo të instrumenteve financiare.

1.30. **Sistemi** - përveç nëse specifikohet ndryshe, i referohet çdo sistemi të pagesave, kliringut apo shlyerjes së letrave më vlerë.

1.31. **Operator i sistemit** - entiteti që është përgjegjës për operimin dhe/apo administrimin e një sistemi të pagesave, kliringut apo shlyerjes së letrave më vlerë.

1.32. **Pjesëmarrës në sistem** - anëtari i një sistemi të pagesave, kliringut apo shlyerjes së letrave më vlerë apo pala në një marrëveshje që themelon një sistem. Kjo mund të përfshijë pjesëmarrësit jo të drejtpërdrejt.

1.33. **Rrezik sistemik** - rreziku që dështimi i një pjesëmarrësi në sistem ose i një pjesëmarrësi në tregjet financiare në përgjithësi, për t'i plotësuar obligimet e tij do të bëjë që pjesëmarrësit tjerë në sistem apo institucionet financiare të mos jenë në gjendje t'i kryejnë obligimet e tyre kur kërkohen ta bëjnë këtë. Një dështim i tillë mund të shkaktoj problem serioze në likuiditet apo problem krediti, dhe si rrjedhojë mund të kërcënoj stabilitetin e tregjeve financiare.

PJESA II RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA E SISTEMIT TË PAGESAVE

KREU I AUTORIZIMI DHE LICENCIMI

Neni 3 Ofrimi i shërbimeve të pagesave

1. Subjekteve të mëposhtme iu lejoheq që të ofrojnë shërbimet e pagesave në Republikën e Kosovës:

1.1. Bankat e rregulluara dhe të licencuara nga Banka Qendrore në pajtim me Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare jo Bankare.

1.2. Institucionet financiare të themeluara më Ligjin për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare jo Bankare të autorizuara nga Banka Qendrore për tu angazhuara në shërbimet e pagesave të specifikuar me autorizim.

2. Më qëllim të marrjes së autorizimit, institucionet financiare duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

2.1. të kenë dhe të mbajnë kapitalin e paguar siç kërkohet me ligjin përkatës.

2.2. të mbrojnë fondet të cilat janë pranuar nga shfrytëzuesit e shërbimit të pagesave ose nëpërmjet një institucioni tjetër të pagesave për ekzekutimin e transaksioneve të pagesave, duke mos i përzier ato asnjëherë me fondet e palëve të treta dhe duke mbajtur ato të paprekura nga kërkesat e kreditorëve tjerë të institucionit të pagesave, veçanërisht në rast të falimentimit.

2.3. të kenë aranzhime të fuqishme të qeverisjes për aktivitetin e shërbimeve të tyre të pagesave, që përshin strukturën e qartë organizative me linja të përcaktuara mirë, transparente dhe të qëndrueshme të përgjegjësisë, procedurë efektive për të identifikuar, menaxhuar, monitoruar dhe raportuar rreziqet ndaj të cilave mund të ekspozohen dhe mekanizma adekuat të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë procedurat e qëndrueshme administrative dhe të kontabilitetit; këto aranzhime, procedura dhe mekanizma duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe në proporcion më natyrën, shkallë dhe kompleksitetin e shërbimeve të ofruara të pagesave.

2.4. të kenë rregulla të qarta për zgjidhje të kontesteve që ndërlidhen me shërbimet e pagesave.

2.5. të kenë një sistem të sigurt të teknologjisë së informacionit dhe ndërfaqe adekuate për të siguruar ndërveprimin dhe qasjen si dhe procedura efikase për kontroll në raste të jashtëzakonshme dhe në fatkeqësi.

3. Më qëllim të përmbushjes së kushteve të përcaktuara në paragrafin 2. të këtij neni, aplikuesi për autorizim duhet të paraqes informacionet e mëposhtme:

3.1. përshkrimin e natyrës dhe fushëveprimin e shërbimeve që ofrohen dhe si këto shërbime përshtaten me strategjinë gjithëpërfshirëse afariste, së bashku me planin e biznesit duke përfshirë një llogaritje të parashikuar të buxhetit për tri (3) vitet e para financiare që demonstroi se aplikuesi është në gjendje që të shfrytëzojë sisteme, burime dhe procedura adekuate dhe proporcionale për të operuar në mënyrë të qëndrueshme;

3.2. listën e produkteve dhe shërbimeve të ofruara;

3.3. përshkrimin e strukturës ligjore të skemës për ofrim të shërbimit, duke përfshirë përkufizimin ligjor të raportit me ndonjë bankë nga e cila shihet qartazi se si ndahen përgjegjësitë dhe si shmangën apo zvogëlohen rreziqet;

3.4. kriteret për përzgjedhjen e agjentëve dhe/apo nënkontraktimin e pjesëve të aktiviteteve, kur është e aplikueshme;

3.5. kopjen e ndonjë marrëveshjeje ndërmjet agjencive apo të nënkontraktimit, sipas nevojës, qoftë individuale ose standarde;

3.6. dëshmitë se ka një numër adekuat të personelit dhe menaxhment kompetent të besueshëm, të trajnuar në mënyre adekuate në lidhje me kërkesat afariste, nevojat operacionale dhe menaxhim të rrezikut në të gjitha rrethanat.

3.7. një dokument të nënshkruar që paraqet në hollësi karakteristikat dhe modalitetet e ndërfaqeve të shfrytëzuara të TI-së, duke përfshirë sistemet operative dhe shpjegimin e softuerit;

3.8. përshkrimin e diagrameve të konfigurimit të çdo sistemi elektronik të pagesave të institucionit dhe mundësive të tij duke përfshirë të gjitha kushtet si në vijim:

3.8.1. që një sistem elektronik i pagesave është i ndërlidhur më sistemet e tjera amë ose me infrastrukturën e rrjetit të institucionit;

3.8.2. si transaksioni dhe të dhënat që qarkullojnë në rrjet, procesi i shlyerjes dhe periudha kohore;

3.8.3. çfarë lloje të linjave të telekomunikimit dhe qasjes nga larg ekzistojnë; dhe

3.8.4. çfarë kontrole dhe masa të sigurisë janë instaluar;

3.9. listën e komponentëve dhe qëllimit të softuerit dhe harduerit në infrastrukturën e pagesave elektronike;

3.10. përshkrim detal se si ndërvepron sistemi me sistemet ekzistuese elektronike të pagesave;

3.11. përshkrim detal se si zbatohen standardet relevante ndërkombëtare, nacionale dhe ato në nivel të industrisë, direktivat dhe rekomandimet kurdoherë që është e kërkueshme;

3.12. Një dokument të nënshkruar të pjesës përkatëse të manualit të politikave dhe procedurave të sigurisë, që përmbajnë në minimum: (1) përshkrimin e organizmit të sigurisë së institucionit, (2) përcaktimin e përgjegjësive për dizajnimin, implementimi, monitorimin dhe përditësimin e masave të sigurisë së informacionit; dhe (3) procedurat e përcaktuara për vlerësimin e pajtueshmërisë më linjën e veprimit, zbatimin e masave disiplinore dhe raportimin e shkeljeve të sigurisë;

3.13. një dokument të nënshkruar që përshkruan planet në raste të jashtëzakonshme dhe për rikuperim pas fatkeqësisë të pajisjeve për pagesa elektronike dhe planin/programin për menaxhimin e skenarit/problemit të ngjarjes më qëllim të adresimit të problemeve, siç janë ankesat, gabimet, ndërhyrjet dhe disponueshmëria e pajisjeve për krijimin e kopjeve rezervë;

3.14. dëshminë mbi zotësinë për të vepruar në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit;

3.15. hollësitë rreth masave për mbrojtje të klientëve, duke përfshirë mekanizmat për adresim të klientëve dhe programin për vetëdijësimin e klientëve;

3.16. hollësitë rreth politikës për mbrojtjen e të dhënave;

3.17. dëshminë mbi certifikimin e infrastrukturës së teknologjisë së shfrytëzuar për operim të rrjetit nga institucionet kompetente;

3.18. identitetin e personave që mbajnë në mënyrë të drejtpërdrejt ose jo të drejtpërdrejt aksione të kualifikuara në aplikuesin;

3.19. identitetin e drejtorëve dhe personave përgjegjës për menaxhimin e subjektit që ofron shërbime, dhe, kur është relevante, personave përgjegjës për menaxhimin e aktiviteteve specifike të shërbimit të pagesave;

3.20. statusin ligjor të aplikuesit;

3.21. identitetin e auditorëve të jashtëm të kontraktuar për auditim dhe firmave të auditimit.

3.22. çdo kërkesë tjetër të përcaktuar nga Banka Qendrore e që në veçanti ndërlidhet më shërbimin e kërkuar.

Neni 4

Emetimi i parave elektronike

1. Përveç kushteve të përgjithshme të caktuara për ofrimin e shërbimeve të pagesave, në veçanti lidhur me emetimin dhe/apo menaxhimin e një instrumenti të pagesave, institucionet financiare që emetojnë para elektronike më anë të kartelave me mbushje apo pajisjeve tjera duhet t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

1.1. ofruesit e parave elektronike marrin përsipër që të paraqesin statistika mbi vlerat e mbushura dhe të shfrytëzuara të parave elektronike në pasqyrat e tyre periodike financiare. Po ashtu duhet të ofrohen informacione të mjaftueshme dhe të besueshme për të monitoruar dhe kontrolluar sasinë dhe shpejtësinë e furnizimit me para elektronike në ekonomi;

1.2. vetëm bankat marrin pjesë në mekanizmat për kliring dhe shlyerje të parave elektronike;

1.3. duhet të sigurohet që shlyerja përfundimtare të bëhet jo më vonë se njëzetekatër orë pas inicimit të udhëzimit për pagesë në sistemin bankar; dhe

1.4. emetuesi do të jetë i detyruar të paguaj vlerën e parave elektronike në të njëjtin nivel, sipas kërkesës. Menaxhimi i rrjedhës themelore dhe rikthimi i vlerës së parasë elektronike nga ana e emetuesit për mbajtësit do të përcaktohen qartë.

Neni 5

Operimi i sistemeve

1. Bankat e rregulluara dhe të licencuara nga Banka Qendrore mund të lejohen që të operojnë me një sistem të licencuar nga Banka Qendrore.

2. Më qëllim që të operohet me një sistem, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

2.1. Operatori i sistemit duhet të ketë burime të mjaftueshme financiare për ushtrimin e duhur të funksioneve të tij dhe për një operim të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të sistemit relevant; në veçanti, operatori i sistemit duhet të ketë në çdo kohë njëqind mijë (100,000) euro të kapitalit të paguar dhe së paku njëqind mijë (100,000) euro të depozitave bankare. Këto shuma janë subjekt i ndryshimit sipas njoftimit të duhur nga Banka Qendrore.

2.2. Operatori i sistemit duhet të ketë aftësi të përshtatshme dhe të mjaftueshme teknike dhe organizative për të operuar me sistemin, duke përfshirë mekanizmat e përshtatshëm për kryerjen e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e rrezikut të ndërlidhur me operimin e sistemit. Në veçanti, operatori i sistemit duhet t'i ketë zhvilluar:

2.2.1. hollësitë e funksionit të auditimit të brendshëm duke përfshirë strukturën, fushëveprimin, linjat e raportimit dhe rregullsinë e raportimit;

2.2.2. analizimin e funksioneve të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë fushëveprimin, strukturën dhe linjat e raportimit më një skemë të bashkangjitur organizative si dhe prova që institucionet kompetente e kanë licencuar infrastrukturën e teknologjisë që operon më sistemin;

2.2.3. planin e burimeve njerëzore për të siguruar burime adekuate për operimin e sistemit.

2.2.4. operatori i sistemit ka një strategji të vlefshme dhe një plan afarist të mbështetur me vlerësime reale për elementet buxhetore dhe listën e të hyrave për pesë vite;

2.2.5. personat e propozuar si anëtarë të menaxhmentit të lartë të operatorit të sistemit duhet të jenë profesionalisht të kualifikuar dhe persona të ndershëm;

2.2.6. qasja në pajisjet e sistemit është subjekt i kritereve të drejta, transparente, jo diskriminuese dhe proporcionale të cilat janë të përcaktuara që të mbrojnë funksionimin e rregullt të sistemit dhe të interesave të pjesëmarrësve në sistem;

2.2.7. likuiditeti i shlyerjes së urdhrave të pranuar nga sistemi është i garantuar dhe i mbrojtur nga rreziku kreditor;

2.2.8. sistemi ka mjete të kënaqshme për mbrojtjen nga prishjet teknike, dhe

2.2.9. ndonjë kusht tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga Banka Qendrore.

3. Sistemi duhet të ketë një libër të rregullave që përcakton:

3.1. kriteret e qarta për qasje, pezullim të qasjes dhe përfundim të qasjes të cilat janë në përputhje me nën-paragrafin 2.2.6. të këtij neni;

3.2. rregullat e qarta dhe adekuate për pranimin, pandryshueshmërinë, shlyerjen dhe karakterin definitiv të urdhrave për transfer;

3.3. rregullat e qarta dhe adekuate për mekanizmat e shlyerjes dhe pagesave;

3.4. rregullat e qarta dhe adekuate për menaxhimin e të gjitha rreziqeve relevante duke përfshirë në veçanti rregullat për menaxhimin e rasteve të mosplotësimit të zotimeve nga një pjesëmarrës në sistem;

3.5. rregullat e qarta dhe adekuate për caktimin e çmimeve që janë në përputhje me këtë ligj;

3.6. rregullat e qarta dhe adekuate për përgjegjësitë dhe detyrimet përkatës të operatorit të sistemit dhe të pjesëmarrësve në sistem;

3.7. rregulla të qarta dhe adekuate për raste të jashtëzakonshme dhe vazhdueshmërinë e funksionimit; dhe

3.8. ndonjë element tjetër që kohë pas kohe mund të përcaktohet nga Banka Qendrore.

Neni 6

Procedurat e autorizimit dhe licencimit

1. Përveç nëse parashihet ndryshe në ndonjë masë implementuese të këtij ligji, procedurat e autorizimit dhe licencimit janë si në vijim:

1.1. kërkesa për dhënie apo ndryshim të licencës/autorizimit paraqitet me shkrim në Bankë Qendrore;

1.2. pas paraqitjes, aplikuesit do t'i kërkohej që të paguaj një tarifë të pakthyeshme të caktuar nga Banka Qendrore për kompletim të kërkesës;

1.3. Banka Qendrore ka mundësi që të kërkojë sqarime dhe informacione plotësuese sipas nevojës gjatë procesit të vlerësimit brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga pranimi;

1.4. Banka Qendrore duhet t'i jap përgjigje me shkrim aplikuesit duke aprovuar ose refuzuar kërkesën brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga pranimi i kërkesës së kompletuar. Megjithatë, nëse kërkesa e paraqitur nuk është e kompletuar dhe Banka Qendrore ka kërkuar sqarim ose informacione plotësuese, procedura pezullohet dhe aplikuesi do të ketë nëntëdhjetë (90) ditë për ta kompletuar atë, ose kërkesa hedhet poshtë automatikisht;

1.5. në rast të vendimit për të refuzuar dhënien e licencës apo autorizimit për aplikuesin, aplikuesi do të njoftohet më shkrim nga Banka Qendrore për arsyet e refuzimit. Aplikuesi ka mundësi që të ankohehet dhe të ri-paraqesë kërkesën;

1.6. gjatë dhënies së aprovimit, Banka Qendrore mund të kërkojë të dhëna shtesë lidhur me kërkesat dhe kushtet e parapara me këtë ligj;

1.7. licenca apo autorizimi jepet për një periudhë të pacaktuar kohore dhe nuk mund të transferohet tek ndonjë person tjetër, apo t'i transferohet një pasardhësi ligjor.

2. Në rast se lloji i shërbimit apo sistemi i ardhshëm nuk mbulohet nga ndonjë masë e përgjithshme ekzistuese nga Banka Qendrore, periudha kohore dhe vargu i veprimeve të përcaktuara në këtë nen për marrje të licencës apo autorizimit nuk zbatohen dhe Banka Qendrore punon në bashkëpunim të ngushtë me aplikuesin për të identifikuar rreziqet dhe mangësitë e skemës së ardhshme afariste dhe miraton të gjitha masat relevante rregullative për të mundësuar një ofrim efikas dhe të sigurt të atij shërbimi të ri.

Neni 7

Revokimi i autorizimit apo licencës

1. Banka Qendrore mund të revokojë apo të pezulloj një autorizim/licencë nëse:

1.1. institucioni financiar/operatori i sistemit nuk ka filluar ofrimin e shërbimit/operimit të pagesave brenda dymbëdhjetë (12) muajve pas datës së autorizimit/licencimit;

1.2. institucioni financiar/operatori i sistemit ka ndërprerë ofrimin e shërbimit/operimit të pagesave për një periudhë prej më shumë se një (1) muaji;

1.3. institucioni financiar/operatori i sistemit ka marrë autorizimin/licencën nëpërmjet deklarimeve të pavërtetat apo ndonjë mjeti tjetër të parregullt;

1.4. institucioni financiar/operatori i sistemit nuk i zbaton kushtet e aplikueshme për autorizim/licencë në bazë të vazhdueshme;

1.5. institucioni financiar/operatori i sistemit dështon në zbatimin e urdhrin të dhënë nga Banka Qendrore në përputhje me nenin 8 të këtij ligji;

1.6. institucioni financiar/operatori i sistemit futet në procedurën e likuidimit;

1.7. ofrimi i shërbimit të pagesave apo operimi i sistemit rrezikon sistemin financiar në Kosovë; ose

1.8. ofrimi i shërbimit të pagesave nuk është më në interes të publikut apo në interesat e pjesëmarrësve në sistem.

2. Menjëherë pas marrjes së vendimit për revokim ose pezullim të licencës, Banka Qendrore e njofton institucionin financiar apo operatorin e sistemit në fjalë, dhe e publikon njoftimin sipas mënyrës që Banka Qendrore e konsideron të përshtatshëm.

KREU II MBIKËQYRJA

Neni 8

Autorizimet e përgjithshme të Bankës Qendrore

1. Më qëllim të mbikëqyrjes efikase dhe transparente të sistemit kombëtar të pagesave si tërësi dhe të pjesëve të tij relevante, Banka Qendrore:

1.1. përcakton standardet, rregullat dhe direktivat e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe/apo operimin e sistemeve me anë të rregulloreve apo udhëzimeve;

1.2. nxjerrë urdhra, vlerëson dhe siguron zbatimin e standardeve, rregullave dhe direktivave të caktuara nëpërmjet monitorimit në vend dhe jashtë, duke përfshirë vendosjen e kushteve, promovimin e efikasitetit dhe shfrytëzimit të shërbimeve të pagesave elektronike, inkurajimit të bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet palëve të interesit.

2. Banka Qendrore ka të drejtë që të ndërmarrë në veçanti hapat si në vijim:

2.1. të kërkojë nga institucioni financiar apo operatori i sistemit që të ofrojë çdo informacion dhe të dhënat e nevojshme për monitorimin e pajtueshmërisë;

2.2. të kryejë inspektimet në vend në institucionin e pagesave apo operatorin e sistemit, në çdo agjent apo palë të tretë që ofron shërbime nën përgjegjësinë e institucionit të pagesave apo operatorit të sistemit;

2.3. të nxjerrë rregullore, udhëzime dhe urdhra, të suspendojë autorizimin apo licencën dhe/apo të shqiptojë dënime administrative ashtu siç specifikohet më tej në këtë ligj.

3. Në zbatimin e politikës së saj të mbikëqyrjes, Banka Qendrore iu përmbahet për aq sa është e mundur standardeve ndërkombëtare, si dhe transparencës dhe dialogut konstant me tregun, në bashkëpunim të plotë me autoritetet tjera relevante vendore dhe ndërkombëtare.

4. Banka Qendrore themelon Këshillin Kombëtar të Pagesave që formohet nga të gjitha palët kryesore të interesit të tregut si një organ këshillues për Bankën Qendrore dhe për rregullimin e funksioneve të saj.

Neni 9

Autoriteti i përgjithshëm për caktimin e kushteve

1. Pavarësisht masave të përgjithshme të autorizimeve të Bankës Qendrore në nenin 8 dhe masat përmirësuese të cekura në nenin 20 të këtij ligji, Banka Qendrore mund të miratojë ose caktojë në lidhje me institucionet e pagesave apo operatorët e sistemit kushte që në mënyrë specifike synojnë të sigurojnë respektimin e objektivave të politikës së saj të mbikëqyrjes.

2. Çdo urdhër i nxjerrë sipas këtij neni i komunikohet personit të cilit i drejtohet dhe do të ketë efekt nga data e nxjerrjes së saj. Urdhri është detyruese për personin të cilit i drejtohet.

3. Menjëherë pas implementimit të urdhrit dhe kompletimit të ndonjë veprimi që kërkohet të ndërmerret në lidhje më të, personi të cilit i është dhënë urdhri e njofton Bankën Qendrore se urdhri është implementuar dhe se veprimi është kompletuar.

Neni 10

Qeverisja e korporatave dhe sistemet e kontrollit të brendshëm

1. Banka Qendrore ka kompetencë që të bëjë aprovimin e emërimit të kryeshefit ekzekutiv dhe anëtarëve të bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë të operatorit të sistemit para dhënies së licencës së tij për të operuar me një sistem në Republikën e Kosovës.

2. Banka Qendrore ka autoritet që të refuzojë propozimin për kryeshef ekzekutiv apo anëtar të bordit të drejtorëve apo menaxhmentit të lartë për një operator të sistemit në bazë të përcaktimit të përvojës së pamjaftueshme apo të papërshtatshme, dënimit për ndonjë veprë që përfshin mashtrimin apo pandershmërinë apo më burgim prej më shumë se gjashtë (6) muaj.

3. Banka Qendrore mund të kërkojë shkarkimin e kryeshefit ekzekutiv dhe anëtarëve të bordit të drejtorëve dhe menaxhmentit të lartë të operatorit të sistemit nëse personi në fjalë ka dështuar të zbatojë dispozitat e këtij ligji, është dënua me burgim prej me shumë se gjashtë (6) muaj.

4. Banka Qendrore mund të kërkojë nga auditorët e jashtëm të operatorëve të sistemit apo institucioneve të pagesave që të kryejnë auditimet specifike financiare dhe të tjera (duke përfshirë sigurinë) në lidhje me ata operatorë të sistemit apo institucione të pagesave për qëllimin e mbikëqyrjes së përcaktuar me këtë ligj. Shpenzimi i auditimeve të tilla do të mbulohe nga operatori i sistemit apo nga institucioni i pagesave që është audituar.

5. Operatorët e sistemit duhet të themelojnë dhe funksionalizojnë auditimin e brendshëm i cili është i ndarë dhe i pavarur nga funksionet dhe aktivitetet tjera të operatorit të sistemit dhe i cili ka përgjegjësitë e mëposhtme:

5.1. të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një plan të auditimit për të ekzaminuar dhe vlerësuar përshtatshmërinë dhe efikasitetin e sistemeve dhe të mekanizmave si dhe aranzhimeve të auditorit të brendshëm;

5.2. të nxjerrë rekomandime në bazë të rezultatit të punës së kryer në përputhje me nënparagrafin 5.1. të këtij paragrafi;

5.3. të verifikojë pajtueshmërinë me këto rekomandime; dhe

5.4. t'i raportojë bordit të drejtorëve të operatorit të sistemit në lidhje me çështjet e auditimit të brendshëm.

Neni 11 Kufizimi i qasjes

1. Banka Qendrore mund të vendos një kufizim të qasjes në lidhje me një sistem të pagesave, kliringut apo shlyerjes së letrave më vlerë ndaj një personi që përcakton qasjen në sistem, pavarësisht nëse ai është një pjesëmarrës në sistem, një operator i sistemit apo një agjent i shlyerjeve, në bazë të rregullave dhe kushteve të cilat mund të konsiderohen të përshtatshme nga Banka Qendrore.

2. Gjatë shqyrtimit nëse duhet të vendoset kufizimi i qasjes sipas paragrafit 1. të këtij neni, Banka Qendrore merr parasysh çështjet si në vijim:

2.1. nëse caktimi i kufizimit të qasjes në lidhje me sistemin do të ishte në interes të publikut;

2.2. interesat e pjesëmarrësve aktual në sistem, operatorit të sistemit dhe agjentit të shlyerjeve;

2.3. interesat e personave të cilët, në të ardhmen, mund të kërkojnë ose të dëshirojnë qasje në sistem; dhe

2.4. çështjet tjera të cilat mund të konsiderohen relevante nga Banka Qendrore.

3. Banka Qendrore, gjatë vendosjes së kufizimit të qasjes sipas paragrafit 1. të këtij neni, siguron që kufizimi i qasjes të jetë i drejtë dhe jo diskriminues.

4. Banka Qendrore do të ketë kompetencë që të bëjë ndryshime ose të revokojë kufizimin e qasjes në bazë të vlerësimit të pikave të lartpërmendura të cekura në paragrafin 2. të këtij neni.

Neni 12 Nënkontraktimi i aktiviteteve

1. Bankat dhe institucionet tjera të autorizuar të pagesave si dhe operatorët e sistemit lejohen që të nënkontraktjnë një pjesë të aktivitetëve të tyre të pagesave tek palët e treta nën përgjegjësinë e tyre dhe sipas autorizimit të veçantë nga Banka Qendrore.

2. Nënkontraktimi i funksioneve të rëndësishme operacionale nuk mund të ndërmerret në atë mënyrë që dëmton materialisht cilësinë e kontrollit të brendshëm të institucionit të pagesave apo të operatorit të sistemit dhe mundësinë e Bankës Qendrore që të monitorojë përmbushjen e të gjitha obligimeve të përcaktuara në këtë ligj nga ana e institucionit të pagesave apo të operatorit të sistemit.

3. Për qëllimet e paragrafit 2. të këtij neni, një funksion operacional konsiderohet si i rëndësishëm nëse defekti apo dështimi në performancën e tij do të dëmtonte materialisht përmbushjen e vazhdueshme nga ana e institucionit të pagesave apo të operatorit të sistemit të kërkesave të autorizimit apo licencës së tij, apo të performancës së tij, apo të qëndrueshmërisë a vazhdimësisë së aktivitetëve të tij.

4. Banka Qendrore siguron se kur një institucion i pagesave apo operator i sistemit i nënkontraktin funksionet e rëndësishme operacionale, ai duhet t'iu përmbahet kushteve të mëposhtme:

4.1. nënkontraktimi nuk duhet të rezultojë në delegimin nga ana e menaxhmentit të lartë të përgjegjësisë së tij;

4.2. raporti dhe obligimet e institucionit të pagesave apo operatorit të sistemit ndaj shfrytëzuesve të shërbimeve të tij të pagesave apo pjesëmarrësve në sistem nuk duhet të ndryshohen;

4.3. kushtet të cilat do t'i përmbush institucioni i pagesave apo operatori i sistemit më qëllim që të autorizohet apo të licencohet dhe të cilat duhet të mbesin si të tilla nuk duhet të ndryshohen; dhe

4.4. asnjë nga kushtet tjera sipas të cilave është dhënë licenca nuk duhet të hiqen apo të modifikohen.

Neni 13 Shfrytëzimi i agjentëve

1. Bankave dhe institucioneve tjera të autorizuar të pagesave iu lejohet që të shfrytëzojnë agjentë sipas autorizimit të veçantë të Bankës Qendrore.

2. Kur një institucion i pagesave ka për qëllim që klientëve t'iu ofrojë shërbime të pagesave nëpërmjet agjentit, ia komunikon informacionet e mëposhtme Bankës Qendrore:

2.1. emrin dhe adresën e agjentit;

2.2. përshkrimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm të cilët do të shfrytëzohen nga agjentët me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dalura nga Ligji për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit; dhe

2.3. identitetin e drejtorëve dhe personave përgjegjës për menaxhimin e agjentit që do të shfrytëzohet për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe dëshminë se ata janë persona të aftë dhe të përshtatshëm.

3. Kur Banka Qendrore i pranon informacionet në përputhje me paragrafin 2. të këtij neni, dhe pas dhënies së autorizimit përkatës, atëherë ajo e regjistron agjentin në një regjistër që është në dispozicion të publikut.

4. Para dhënies së autorizimit dhe regjistrimit të agjentit në regjistër, Banka Qendrore, nëse konsideron se informacionet e dhëna janë të pasakta, duhet të ndërmarr veprime tjera për verifikim të informacioneve.

5. Institucionet e pagesave sigurojnë se agjentët që veprojnë në emër të tyre i njoftojnë shfrytëzuesit e shërbimit të pagesave për këtë fakt.

Neni 14 Përgjegjësia

1. Kur institucionet e pagesave apo operatorët e sistemit mbështetën në palët e treta për ushtrimin funksioneve operacionale, këto institucione të pagesave apo operatorë të sistemit ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të siguruar përmbushjen e kërkesave të këtij ligji.

2. Institucionet e pagesave dhe operatorët e sistemit janë plotësisht përgjegjës për çdo veprim të punonjësve të tyre, të ndonjë agjenti apo entiteti të cilit i janë nënkontraktuar aktivitetet.

Neni 15 Mbajtja e shënimeve

1. Institucionet e pagesave dhe operatorët e sistemit mbajnë të gjitha shënimet e duhura për qëllimin e këtij ligji për së paku pesë (5) vite.

2. Shënimet mbahen në një medium që mundëson ruajtjen e informacioneve në atë mënyrë që është e qasshme për referim në të ardhmen nga Banka Qendrore dhe në atë formë dhe mënyrë që siguron plotësimin e kushteve të mëposhtme:

2.1. Banka Qendrore duhet të jetë në gjendje të ketë qasje në to pa vështirësi dhe të ristrukturojë çdo fazë kyçe të procesimit të çdo pagese/shlyerje;

2.2. duhet të bëhet i mundshëm çdo korigjim apo ndryshim tjetër, dhe që përmbajtjet e shënimeve para një korigjimi apo ndryshimi të tillë, duhet të jenë lehtë të vërtetueshme; dhe

2.3. nuk duhet të jetë e mundshme që shënimet të manipulohen apo të ndryshohen në mënyra tjera.

Neni 16 Operimi i sistemeve dhe ofrimi i shërbimeve nga Banka Qendrore

1. Banka Qendrore mund të organizojë, marrë pjesë dhe të operojë më një apo më tepër sisteme të pagesave si dhe t'iu sigurojë lehtësi sistemeve të tilla dhe pjesëmarrësve në këto sisteme, duke përfshirë kreditimin ndër-ditor në formë të kolateralit nga letrat më vlerë të këmbyeshme të qeverisë. Ajo mund të bëjë të detyrueshëm pjesëmarrjen në sistemet e saj kur kjo është në interes të publikut.

2. Banka Qendrore po ashtu është në gjendje që të veprojë si agjent, palë tjetër qendrore, shtëpi e kliringut dhe mbajtës qendror i letrave më vlerë.

3. Procesi i licencimit sipas këtij kreu nuk zbatohet për sistemet e pagesave, kliringut dhe shlyerjes së letrave më vlerë të cilat zotërohen dhe operohen nga Banka Qendrore.

4. Pavarësisht paragrafit 3. të këtij neni, sistemet e pagesave, kliringut dhe shlyerjes së letrave më vlerë të cilat zotërohen apo operohen nga Banka Qendrore iu përmbahen kërkesave të miratuara nga Banka Qendrore e që zbatohen edhe për sistemet e ngjashme të licencuara.

Neni 17
Lista e sistemeve

Banka Qendrore publikon listën e sistemeve dhe operatorëve të sistemeve të licencuara si dhe të sistemeve që zotërohen apo operohen nga Banka Qendrore.

KREU III
PËRFUNDIMI, ZBATUESHMËRIA E NETIMIT DHE FALIMENTIMI

Neni 18
Përfundimi dhe zbatueshmëria e netimit

1. Pavarësisht nga çfarëdo që mund të jetë në kundërshtim:

1.1. rregullat e shlyerjes së një sistemi janë të vlefshme dhe detyruese për një shtëpi të kliringut, pjesëmarrësit në sistem, palën tjetër qendrore dhe Bankën Qendrore. Çdo veprim mund të iniciohet në mënyrë të vlefshme apo çdo pagesë mund të bëhet në përputhje me rregullat e këtilla të shlyerjes;

1.2. obligimi i pjesëmarrësit në sistem, shtëpisë së kliringut apo palës tjetër qendrore për të bërë pagesa për një pjesëmarrës në sistem, dhe e drejta e pjesëmarrësit në sistem, shtëpisë të kliringut apo palës tjetër qendrore për të pranuar pagesa nga pjesëmarrësi në sistem, shtëpia i kliringut apo pala tjetër qendrore netohen, dhe shlyerja neto apo shuma përmbyllëse përcaktohet në përputhje me rregullat e shlyerjes së sistemit;

1.3. kur rregullat e shlyerjes së një sistemi parashohin se shlyerja e një obligimi të pagesës nëpërmjet regjistrimit apo bërjes së një pagese nga llogaria e një pjesëmarrësi në sistem, shtëpia e kliringut apo pala tjetër qendrore në Bankën Qendrore është përfundimtare dhe e pakthyeshme, regjistrimi apo pagesa nuk do të kthehet, ri-paguhet apo mënjanohet.

Neni 19
Përfundimi, falimentimi apo administrimi i operatorit të sistemit apo pjesëmarrësit në sistem

1. Urdhërpagesat të cilat janë regjistruar në sistem dhe netimi i tyre është ligjërisht i zbatueshëm dhe detyrues për palët e treta. Në rast të fillimit të procedurës së falimentimit kundër një pjesëmarrësi në sistem, urdhërpagesat të cilat janë regjistruar në sistem para fillimit të procedurës së falimentimit janë ligjërisht të zbatueshme dhe detyruese ndaj palëve të treta.

2. Urdhërpagesat të cilat janë regjistruar në sistem pas fillimit të procedurës së falimentimit dhe janë ekzekutuar në ditën e fillimit të procedurës së falimentimit, urdhërpagesat e tilla janë ligjërisht të zbatueshme dhe detyruese për palët e treta, më kusht që operatori i sistemit, në kohën e ekzekutimit të urdhërit, nuk ka qenë në dijeni e as që ka mundur të jetë në dijeni për fillimin e procedurës së tillë.

3. Momenti specifik i regjistrimit të një urdhërpagese në sistem përcaktohet nga rregullat e atij sistemi.

4. Pjesëmarrësi i sistemit kundër të cilit nxjerret një aktgjykim, urdhër, apo i cili ka nxjerrë një vendim për përfundimin vullnetar të aktiviteteve në ditën e pranimit apo nxjerrjes së aktit e njofton pa vonesë Bankën Qendrore dhe operatorin e sistemit.

5. Procedura e falimentimit nuk ka ndonjë efekt retroaktiv mbi të drejtat dhe obligimet e pjesëmarrësit në sistem, që lind nga kliringu dhe shlyerja e obligimeve të pagesave në një sistem të caktuar para kohës së fillimit të një procedure të tillë.

6. Regjistrimi apo kryerja e një pagese nga llogaria e një pjesëmarrësi në sistem, shtëpie të kliringut apo pale tjetër qendrore në Bankën Qendrore për të shlyer një obligim të pagesës nuk i nënshtrohet ndonjë dispozite apo urdhërese që shërben si pezullim i atij aktiviteti.

7. Të drejtat dhe përgjegjësitë e një pjesëmarrësi në sistem, shtëpie të kliringut, pale tjetër qendrore apo Bankës Qendrore, në lidhje me kolateralin që i është dhënë si siguri për një pagesë apo për kryerjen e një obligim të krijuar në sistem, mund të mos ndikohet nga procedura e falimentimit. Në veçanti, këto të drejta dhe përgjegjësi mund të mos jenë subjekt i ndonjë procedure apo urdhri të pezullimit që ndikon në aftësinë e kreditorëve për t'i ushtruar të drejtat dhe përgjegjësitë në lidhje me kolateralin.

8. Shuma që tejkalon kërkesën apo bilanci i debitit që rezulton nga operacionet e sistemit të përshkruar më lartë paguhet në procedurën e falimentimit. Kërkesa që është e paplotësuar me rezultatin e realizmit apo më bilancin kreditor mund të zbatohet kundrejt procedurës së falimentimit sipas dispozitave që zakonisht zbatohen në këtë rast.

9. Të drejtat dhe masat përmirësuese të një operatori, pjesëmarrësi në sistem, shtëpie të kliringut, pale tjetër qendrore apo Bankës Qendrore, në lidhje me kolateralin që i është dhënë si siguri për një pagesë apo për kryerjen e një obligim të krijuar në sistem, nuk ndikohen nga procedura e paaftësisë paguese ose falimentimit apo nga ndonjë ligj tjetër i ngjashëm më këtë qëllim dhe efekt. Në veçanti, këto të drejta dhe masat përmirësuese mund të mos jenë subjekt i ndonjë procedure apo urdhërese të pezullimit që ndikon në aftësinë e kreditorëve për t'i ushtruar të drejtat dhe masat përmirësues në lidhje me kolateralin.

KREU IV SHKELJET, MASAT PËRMIRËSUESE DHE DËNIMET

Neni 20 Shkeljet dhe masat përmirësuese

1. Masat përmirësuese dhe dënimet e parapara për shkeljet e parapara në këtë nen shqiptohen nga Banka Qendrore. Veprimi bazohet në seriozitetin e shkeljes, efektin e saj në rrezikun sistemik, fazën në të cilën ajo është zbuluar, nëse është raportuar në mënyrë vullnetare nga kryesi, dhe çfarë mase është e përshtatshme për të përmirësuar apo për t'i japë fund shkeljes.

2. Banka Qendrore ndërmerr një të njëzën nga veprimet e mëposhtme administrative apo të shqiptojë masat disiplinore administrative nëse konstatohet se është kryer një shkelje që përbëhet nga shkelja e një dispozite të këtij ligji apo ndonjë mase të Bankës Qendrore të nxjerrë në përputhje me këtë ligj:

2.1. lëshon vërejtje me shkrim;

2.2. lëshon urdhra me shkrim për të ndërmarr veprime përmirësuese;

2.3. cakton kufizime apo gjoba për kryesin në shumë prej njëqind (100) deri në njëmijë (1000) Euro në ditë për çdo ditë që vazhdon shkelja;

2.4. suspendon përkohësisht apo shkarkon zyrtarët, menaxherët apo punonjësit e shkelësve nga pozitat e tyre; apo

2.5. suspendon apo anulon licencën apo autorizimin.

3. Vendimet e Bankës Qendrore apo të agjentëve të saj sipas këtij ligji mund të jenë subjekt i rishikimit gjyqësor vetëm ashtu siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore.

Neni 21

Veprat penale dhe dënimet

1. Çdo person që bie ndesh më nenet 3, 4 dhe 5 të këtij ligji kryen veprë penale dhe pas shpalljes fajtor mund të dënohet më burgim deri në shtatë (7) vite dhe më gjobë deri në tridhjetë mijë (30,000) euro.

2. Nëse kryeshefi ekzekutiv, drejtori apo një punonjës i institucionit të pagesave apo operatorit të sistemit a pjesëmarrësit në sistem:

2.1. pengon ushtrimin e aktiviteteve të duhura të auditorit në përputhje më këtë ligj apo inspektimin e Bankës Qendrore nga një inspektor i autorizuar në mënyrë të duhur nga Banka Qendrore;

2.2. dëmton, shkatërron, ndryshon apo falsifikon llogaritë, librat apo shënimet e institucionit të pagesave, operatorit të sistemit apo pjesëmarrësit të sistemit; apo,

2.3. më qëllim të mashtrimit, regjistron të dhënat të pavërteta apo dështon në regjistrimin e të dhënave materiale në llogaritë e institucionit të pagesave, sistemit të pagesave ose të pjesëmarrësit në sistem, kryen veprë penale dhe pas shpalljes fajtor mund të dënohet më burgim deri në pesë (5) vite dhe më gjobë deri në njëzet mijë (20.000) euro.

3. Çdo person që shkel apo pengon në mënyra tjera dispozitat e këtij ligji kryen veprë penale dhe pas shpalljes fajtor mund të dënohet më burgim deri në tre (3) vite, me gjobë deri në dhjetë mijë (10.000) euro, ose më të dyja bashkë.

PJESA III

EKZEKUTIMI I TRANSAKSIONEVE TË PAGESAVE

KREU I

DETYRAT E PËRGJITHSHME TË INSTITUCIONEVE TË PAGESAVE

Neni 22

Përkufizimet

1. Për qëllimet e kësaj pjese shprehjet e përdorura kanë këtë kuptim:

1.1. **Kartelë** - çdo kartelë, duke përfshirë kartelën për debit, kredit, Bankomate, Pika të Shitjes apo kartelën mbushëse, që shfrytëzohen nga klienti për të kryer një transferim të fondeve, dhe duke përjashtuar kartelat e lëshuara nga tregtarët vetëm për përdorim në dyqanin apo në rrjetin e dyqaneve të tyre;

1.2. **Transfer i kreditit** - një transaksion i pagesës i iniciuar nga paguesi, i cili lëshon një urdhërpagesë për institucionin e tij, duke udhëzuar atë që t'i transferojë fondet nga llogaria e paguesit te i paguari ose në llogarinë e të paguarit;

1.3. **Klient** - një person fizik a juridik që shfrytëzon instrumentet e pagesës apo shërbimet e pagesave të ofruar nga institucioni i pagesave;

1.4. **Transfer i debitit** - një transaksion i pagesës i iniciuar nga urdhërpagesa e të paguarit, sipas autorizimit të paguesit, me të cilën urdhërohet institucioni i të paguarit për t'i tërhequr paratë nga llogaria e paguesit;

1.5. **Miratim elektronik** - çdo zë, simbol a proces i cili është:

1.5.1. i ndërlidhur me teknologjinë (1) që ka veti elektrike, digjitale, magnetike, pa tela, optike, e elektromagnetike a të ngjashme, duke përfshirë (por pa u kufizuar në) telefoninë mobile, faksimilin dhe internetin dhe (2) i cili mund të qaset vetëm me anë të kodit të qasjes së sigurisë; dhe

1.5.2. logjikisht i lidhur më një marrëveshje të detyrueshme ligjore apo autorizim dhe i ekzekutuar apo i pranuar nga një person më qëllim të t'i përmbahet një marrëveshje apo autorizimi të tillë.

1.6. Sistem për transfer elektronik të fondeve - një sistem i pagesave që ekzekuton transferet e parave ose në mënyrë elektronike ose më anë të ndonjë mjeti tjetër jo të bazuar në letra, që mbështet transferin e fondeve të ekzekutuar nga ndonjëri prej këtyre kanaleve apo kombinimit të tyre:

1.6.1. терминаlet e pikave të shitjes (POS);

1.6.2. Bankomatët (ATM);

1.6.3. kanalet kabllore, të internetit dhe kanalet tjera të komunikimit;

1.6.4. instrumentet telefonike, duke përfshirë telefonat mobil;

1.6.5. kartelat me vlera të ruajtura, të kreditit dhe debitit.

1.7. Kontratë kornizë - një kontratë e cila rregullon ekzekutimin e ardhshëm të transfereve individuale dhe pasuese dhe të cilat mund të përmbajnë obligimin dhe kushtet për të krijuar një llogari për ekzekutimin e transfereve të tilla;

1.8. I paguari - personi i cili synohet të jetë përfituesi përfundimtar i fondeve;

1.9. Institucioni i pagesave të të paguarit - institucioni i pagesave në një urdhërpagesë i cili do t'ia kryejë pagesën të paguarit

1.9.1. duke kredituar llogarinë e të paguarit; apo

1.9.2. në ndonjë mënyrë tjetër, ku urdhërpagesa nuk shërben për kreditim të llogarisë.

1.10. Paguesi - personi që mban një llogari bankare dhe lejon një urdhërpagesë duke debituar atë llogari; apo, kur nuk ka llogari bankare, personi që inicion transferin e fondeve në përfitim të të paguarit;

1.11. Institucion pranues - institucioni të cilit i është adresuar instruksioni i dërguesit;

1.12. Kodi i Sigurisë së Qasjes - numri personal i identifikimit (PIN), fjalëkalimi, kodi apo ndonjë mjet tjetër që siguron mundësinë e qasjes së siguruar në llogarinë e klientit për qëllim të, ndër tjerash, inicimit të transferit të fondeve me anë të mjeteve elektronike;

1.13. Procedurë e sigurisë - procedura e përcaktuar me marrëveshje të klientit dhe institucionit pranues më qëllim të:

1.13.1. verifikimit se urdhërpagesa apo komunikimi që ndryshon apo anulon një urdhërpagesë është i vetë klientit; apo

1.13.2. zbulimit të gabimit në transmetimin e përmbajtjes së urdhërpagesës apo shkresës. Procedura e verifikimit mund të kërkojë shfrytëzimin e algoritmeve apo kodeve tjera, që identifikojnë fjalët apo numrat, enkriptimin, procedurat kthyesë a pajisjet e ngjashme të sigurisë. Krahasimi i nënshkrimit në një urdhërpagesë apo komunikim më mostrën e nënshkrimit të autorizuar të klientit.

1.14. **Dërgues** - personi që i jap udhëzim institucionit pranues, qoftë ai pagues apo i paguar siç mund të jetë rasti. Dërgues po ashtu do të jetë edhe institucioni pranues që udhëzon një institucion tjetër për qëllimet e ekzekutimit të transferit të fondeve.

Neni 23

Transparenca dhe e drejta për tu informuar në mënyrë adekuate

1. Institucioni i pagesave ka për detyrë të përgjithshme që të njoftojë klientët dhe publikun në përgjithësi për kushtet e shërbimeve të tij dhe të veprojë me transparencë të plotë.
2. Në këtë drejtim, kur ky ligj përcakton obligimin e përgjithshëm të institucionit të pagesave për t'i ofruar klientit informacione specifike, ai duhet të sigurojë informacione të tilla pa pasur nevojë për një kërkesë specifike nga klienti në atë mënyrë që të mos kërkoj ndonjë aktivitet specifik nga klienti për marrjen e informacioneve të njoftimit me to.
3. Kur me këtë ligj shprehimisht përcaktohet se institucioni i pagesave ia siguron informacionet e kërkuara klientit të miratuar në mënyrë të veçantë, ai duhet t'i përmbahet asaj. Megjithatë, ai gjithmonë vepron në atë mënyrë që i'a mundëson klientit pranimin e informacioneve të plota dhe të besueshme.

Neni 24

Kushtet dhe rregullat

1. Një institucion i pagesave duhet të ketë kushte dhe rregulla standarde në lidhje me kryerjen e transaksioneve të pagesave dhe emetimin dhe menaxhimin e instrumenteve të pagesave.
2. Ato duhet të jenë më shkrim dhe në mënyrë të qartë, dhe lehtë të kuptueshme dhe të zbatueshme.
3. Kushtet dhe rregullat standarde i tregohen klientit nga ana e institucionit para përdorimit të instrumentit të pagesave apo kryerjes së transaksionit.
4. Kushtet dhe rregullat standarde përfshijnë:
 - 4.1 përgjegjësinë e klientit për çdo transfer të paautorizuar dhe detyrën për të raportuar shpejt tek institucioni ndonjë humbje, keqpërdorim, vjedhje apo shfrytëzim të paautorizuar të kodit të qasjes apo të kartelës a instrumentit tjetër të pagesave;
 - 4.2. numrin e telefonit dhe adresën e departamentit përgjegjës të institucionit që do të njoftohet në rast se klienti beson se është apo mund të preket nga një transfer i paautorizuar;
 - 4.3. të drejtën e klientit për të ndaluar një transfer të autorizuar më herët dhe kushtet dhe procedurat për inicimin e ndalimit të një urdhërpaguese të këtitillë;
 - 4.4. kohën maksimale për ekzekutimin e çdo lloj transferi që do të ekzekutohet;
 - 4.5. të gjitha detyrimet e pagueshme nga klientin dhe, kur është e aplikueshme, zberthimin e shumave të çdo detyrimi;
 - 4.6. kur është e aplikueshme, rregullat për llogaritjen e normës së këmbimit që do zbatohet për çdo lloj transferi që do të ekzekutohet;
 - 4.7. informacionet lidhur më paraqitjen e ankesave, hetimin dhe procedurat për zgjidhjen e tyre; dhe

4.8. të drejtën e klientit për të pranuar dokumentet përkatëse lidhur me transaksionet individuale.

5. Udhëzimi i klientit për të ndaluar pagesën e një transferi të autorizuar më herët i cekur në nën-paragrafin 4.3 të këtij neni do të procesohet menjëherë përveç nëse klienti dhe institucioni janë dakorduar ndryshe ku është definuar një datë apo kohë e caktuar.

6. Për qëllimet e këtij neni, “**transfer i autorizuar më herët**” do të thotë çdo aranzhim a marrëveshje paraprake ndërmjet klientit dhe institucionit për ta autorizuar atë që

6.1. të bëjnë pagesa për palët e treta nga fondet që gjenden në llogarinë e klientit; apo

6.2. të transferojnë fondet nga një llogari e klientit në një llogari tjetër të klientit që mbahet në atë institucion apo në një institucion tjetër.

7. Institucioni i pagesave i vë në dispozicion kopjet e kushteve dhe rregullave standarde në zyrat apo agjentët e tij.

8. Kushtet dhe rregullat aprohen nga Banka Qendrore kur institucionit të pagesave i jepet autorizimi për fillimin e aktiviteteve të tij. Në rast se nga institucioni i pagesave nuk kërkohet që të aplikojë për një autorizim specifik për ofrimin e shërbimeve të pagesave, atëherë kushtet dhe rregullat për një instrument specifik të pagesave i paraqitën për aprovim Bankës Qendrore në kohë të duhur para hyrjes së tyre në fuqi. Kjo dispozitë nuk nënkupton në asnjë mënyrë se Banka Qendrore ka ndonjë detyrim për të aprovuar politikat e caktimit të çmimeve, të cilat nuk janë objekt i autorizimit.

Neni 25 Ndryshimet e kushteve dhe rregullave

1. Institucioni i pagesave mund të ndryshojë apo të modifikojë kushtet dhe rregullat standarde që rregullojnë ekzekutimin e transaksioneve të pagesave dhe emetimin dhe menaxhimin e instrumenteve të pagesave në lidhje me:

1.1. caktimin apo ngritjen e tarifës;

1.2. shtimin e detyrimit së klientit për dëmet; apo

1.3. përshtatjen e limiteve të transaksionit për shfrytëzimin e kartelës, më kusht që ai t’ia jap klientit një njoftim pesëmbëdhjetë (15) ditë më herët.

2. Njoftimi mund të sigurohet përmes postes elektronike, nëse preferohet kështu nga klienti.

Neni 26 Njoftimi i ndryshimeve tjera

1. Institucion i pagesave mund ta njoftojë klientin për ndonjë ndryshim tjetër në kushtet dhe rregullat standarde nëpërmjet:

1.1. njoftimit në pasqyrat periodike të llogarisë;

1.2. njoftimit në bankomate, pika të shitjes apo në terminale tjera elektronike;

1.3. njoftimit në zyrat e tij; apo

1.4. ndonjë mënyrë tjetër që ai e konsideron të përshtatshme.

2. Kur njoftimi jepet sipas paragrafit 1. Nën-paragrafëve 1.2., 1.3. apo 1.4. të këtij neni dhe klienti nuk njoftohet drejtpërsëdrejti, atëherë klientit i jepet një njoftim pasues nga ana e institucionit.

3. Njoftimi mund të sigurohet përmes postës elektronike, nëse preferohet kështu nga klienti.

4. Pavarësisht nga paragrafi 1. i këtij neni, një njoftim paraprak duhet të bëhet kur ndryshimet janë bërë të domosdoshme nga nevoja e menjëhershme për të kthyer apo ruajtur sigurinë e transferimit të fondeve, të sistemit të pagesave apo të një llogaria individuale.

Neni 27

Informacionet lidhur me transaksionet individuale të pagesave dhe lëshimi i dëftesave

1. Para çdo transaksioni individual të pagesës, institucioni i pagesave ofron, me kërkesë të klientit, informacione specifike për kohën maksimale të ekzekutimit dhe tarifave të aplikueshme, dhe, kur është e aplikueshme, normat e aplikuara të këmbimit.

2. Përveç nëse dakordohen ndryshe, në kohën e urdhërpagesës, institucioni i pagesave siguron që dëftesa i lëshohet klientit duke përmblajtur të gjithat nga informacionet e mëposhtme:

2.1. shumën e transferit;

2.2. datën dhe kohën (nëse është e zbatueshme) e transferit;

2.3. llojin e transferit;

2.4. shumën e çdo tarife të pagueshme nga paguesi;

2.5. shënimin e shumave të cilat janë debituar apo kredituar;

2.6. të dhënat të cilat ia mundësojnë institucionit të pagesave që të identifikojë klientin dhe transferin;

2.7. kur është e mundur, llojin dhe lokacionin e përgjithshëm të çdo pajisje të institucionit që përdoret për të kryer transaksionin apo numrin a simbolin që mundëson identifikimin e atyre pajisjeve të institucionit;

2.8. emrin e të paguarit, të cilit i bëhet pagesa;

2.9. kur është e mundur dhe kur ka gjasë që të mos komprometoj privatësinë apo sigurinë e paguesit, bilanci i mbetur në llogarinë e cila debitohet në transfere (apo, në rast të depozitimit, shuma e cila kreditohet).

3. Nëse një urdhërpagesë jepet nëpërmjet komunikimeve me zë (duke përfshirë sistemin automatik të përgjigjes me zë nga telefoni), institucioni i pagesave siguron se informacionet e mëposhtme i ofrohen klienti nëpërmjet komunikimit me zë në kohën e urdhrit:

3.1. numri i dëftesës;

3.2. shuma e transferit;

3.3. lloji i transferit;

3.4. shënimin e shumave të cilat janë debituar apo kredituar;

3.5. emrin e të paguarit, të cilit i bëhet pagesa;

3.6. kur është e mundur dhe kur ka gjasë që të mos komprometoj privatësinë apo sigurinë e paguesit, bilanci i mbetur në llogarinë e cila debitohet në transfere (apo, në rast të depozitimit, shuma e cila kreditohet).

4. Institucionet e pagesave mund të zgjedhin që t'iu ofrojnë shfrytëzuesve të shërbimit opSIONIN për të specifikuar në kohën e secilit transfer se dëftesa nuk është e nevojshme.

5. Dëftesa mund të jenë në formatin elektronik.

6. Përdoruesi nuk mund të ngarkohet me tarifë për lëshim të dëftesës në pajtim me paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni.

7. Në rast se pajisjet e institucionit mund të mos jenë në gjendje që të printojnë dëftesat, përdoruesi duhet të njoftohet se dëftesa nuk do ofrohet në vend, para procesimit të transferit, në mënyrë që përdoruesi të mund të marrë një vendim të informuar nëse do të vazhdojë me transferin pa dëftesë.

Neni 28 **Vlera dëshmuese e dëftesave**

Në çdo veprim ligjor, dëftesat e lëshuara sipas nenit 27 të këtij ligji të cilat tregojnë se është kryer një transfer, pranohen si dëshmi e një transferi të tillë dhe paraqesin një provë se kjo është bërë.

KREU II **EKZEKUTIMI I TRANSFEREVE**

Neni 29 **Ekzekutimi**

1. Institucioni pranues e ekzekuton një urdhërpagesë të iniciuar nga paguesi brenda përfundimit të ditës së nesërme të punës përveç nëse udhëzohet ndryshe nga dërguesi, por megjithatë, në asnjë rast institucioni pranues nuk obligohet që të ekzekutojë urdhërpagesën nëse nuk ka fonde të mjaftueshme në shumën prej nga do të barten fondet.

2. Institucioni i të paguarit e krediton llogarinë e të paguarit brenda përfundimit të ditës së nesërme të punës nga pranimi i urdhërpagesës.

3. Kur urdhërpagesa iniciohet nga ose nëpërmjet të paguarit, institucioni i pagesave të të paguarit ia përcjellë atë institucionit të pagesave të paguesit brenda afateve kohore të dakorduara nga i paguari dhe institucioni i tij i pagesave, duke mundësuar shlyerjen, për aq sa ka të bëjë me debitimin direkt, në datën e dakorduar më kohë.

Neni 30 **Pranimi i urdhërpagesave**

1. Koha e pranimit është koha kur urdhërpagesa që bartët drejtpërsëdrejti nga paguesi apo në mënyrë jo të drejtpërdrejt nga ose nëpërmjet të të paguarit pranohet nga institucioni i pagesave të paguesit.

2. Institucioni i pagesave të paguesit mund të caktojë një afat kohor të prerjes gjatë ditës së punës për pranimin dhe përpunimin e urdhërpagesave. Afatet kohore të prerjes së ndryshme mund të caktohen për urdhërpagesa apo për kategori të ndryshme të urdhërpagesave. Koha e prerjes mund të zbatohet për dërguesit në përgjithësi apo afatet e ndryshme kohore mund të zbatohen për dërguesit e ndryshëm apo për kategoritë e ndryshme të urdhërpagesave.

3. Nëse një urdhërpagesë pranohet pas përfundimit të ditës së punës apo pas kohës së prerjes, institucioni pranues mund ta trajtojë urdhërpagesën si të pranuar në fillimin e ditës së ardhshme të punës.

4. Institucioni i pagesave e njofton klientin për çfarëdo kohe të prerjes ose periudha kohore në ditën e punës për pranimin dhe procedimin e urdhërpagesave dhe për ndonjë ndryshim lidhur më to.

Neni 31

Pandryshueshmëria

1. Paguesi nuk mund të anulohet urdhërpagesën pasi që ajo është pranuar nga institucioni i pagesave të pagesit, përveç rasteve kur parashihet ndryshe me marrëveshje.
2. Kur urdhërpagesa iniciohet nga ose nëpërmjet të paguarit, pagesi nuk mund të anulohet urdhërpagesën pas transmetimit të urdhërpagesës apo dhënies së pëlqimit për ekzekutim të transaksionit të pagesës për të paguarin. Pavarësisht nga ndonjë e drejtë për kompensim që ai mund të ketë, pagesi mund të anulohet urdhërpagesën më së voni deri në përfundim të ditës së punës që i paraprin ditës kur janë pajtuar për debitim të fondeve.
3. Rregullat e aplikueshme për urdhërpagesat zbatohen në mënyrë të njëjtë edhe për komunikimet që pezullojnë apo ndryshojnë një urdhërpagesë.

Neni 32

Transmetimi i urdhërpagesave nëpërmjet sistemit të transferimeve elektronike të fondeve

1. Nëse një urdhërpagesë që do t'i adresohet institucionit pranues transmetohet në sistemin e transfereve elektronike të fondeve, ky sistem konsiderohet të jetë një agjent i dërguesit më qëllim të transmetimit të urdhërpagesës tek institucioni. Nëse ekziston ndonjë mospërputhje ndërmjet kushteve të urdhërpagesës të transmetuar në sistemin e transfereve elektronike të fondeve nga dërguesi dhe kushteve të urdhërpagesës së transmetuar nga ky sistem tek institucioni, kjo e fundit mbizotëron, përveç nëse parashihet ndryshe nga rregullat e këtij sistemi.
2. Institucioni i pagesave nuk duhet t'i shmanget asnjë obligimi ndaj klientit të tij vetëm për arsye të faktit se ai është palë në sistemin e përbashkët të transfereve elektronike të fondeve dhe se një palë tjetër në sistem ka dështuar në përmbushjen e obligimeve të tij sipas këtij ligji.
3. Të drejtat dhe përgjegjësitë përkatëse të palëve në sistemin e përbashkët të transfereve elektronike të fondeve përcaktohen më anë të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe e që i nënshtrohet mbikëqyrjes së Bankës Qendrore.

KREU III

TRANSFERET E PAAUTORIZUARA DHE TË GABUARA TË FONDEVE

Neni 33

Autorizimi i transferove

1. Një transfer i fondeve konsiderohet i autorizuar vetëm nëse dërguesi ka dhënë miratim për ekzekutimin e një transferi të tillë.
2. Miratimi për ekzekutimin e një transferi të fondeve apo të një serie të transfereve jepet në formën e dakorduar nga palët.
3. Në mungesë të një miratimi të tillë, transferi konsiderohet si i paautorizuar.
4. Nëse institucioni i pagesave dhe klienti i tij pajtohen se vërtetësia e urdhërpagesave të lëshuara për institucionin e pagesave në emër të klientit si dërgues do të verifikohen sipas procedurës së sigurisë, urdhërpagesa e pranuar nga institucioni pranues është po aq e vlefshme sikurse urdhri i klientit, pavarësisht se a është ose jo e autorizuar, nëse:
 - 4.1. procedura e sigurisë është një metodë e arsyeshme në aspektin e tregut të ofrimit të sigurisë kundër urdhërpagesave të paautorizuara; dhe

4.2. institucioni dëshmon se e ka pranuar urdhërpagesën në mirëbesim dhe në pajtueshmëri me procedurën e sigurisë dhe ndonjë marrëveshje apo instruksion me shkrim nga ana e klientit që kufizon pranimin e urdhërpagesave të lëshuara në emër të klientit. Institucioni nuk kërkohet që t'i përmbahet një udhëzimi që shkel marrëveshjen më shkrim me klientin apo njoftimi i të cilit nuk është pranuar në kohën dhe në mënyrën që institucionit i ofron mundësi të arsyeshme që të veprojë në të para pranimin të urdhërpagesës.

Neni 34 **Urdhërpagesat e gabuara**

1. Kur një urdhërpagesë iniciohet nga paguesi, institucioni i pagesave të paguesit është përgjegjës ndaj paguesit për ekzekutimin e saktë të transaksionit të pagesës, përveç nëse institucioni i pagesave mund të dëshmojë se gabimi ishte bërë nga paguesi, apo nëse institucioni i pagesave mund t'ia dëshmojë paguesit dhe, kur është relevante, institucionit të pagesave të të paguarit, se institucioni i pagesave të të paguarit e ka pranuar në mënyrë të saktë transaksionin e pagesës, ku në këtë rast, institucioni i pagesave të të paguarit është përgjegjës ndaj të paguarit për ekzekutimin e saktë të transaksionit të pagesës.

2. Nëse një urdhërpagesë është bërë në pajtim me procedurën e sigurisë për zbulim të gabimeve, dhe urdhërpagesa:

2.1. gabimisht urdhëron pagesën për të paguarin që nuk ka qenë qëllim i dërguesit;

2.2. gabimisht urdhëron pagesën në shumën më të madhe ose më të vogël se shuma që ka pasur për qëllim dërguesi; apo

2.3. ka qenë një kopje identike e paraqitur gabimisht e urdhërpagesës së dërguar më parë nga dërguesi, atëherë zbatohen rregullat si në vijim:

2.3.1. nëse dërguesi dëshmon se dërguesi apo një person që vepron në emër të dërguesit i është përmbajtur procedurës së sigurisë dhe se gabimi do të zbulohet nëse edhe institucioni pranues po ashtu do t'i ishte përmbajtur asaj procedure, dërguesi nuk është i obliguar që të paguaj urdhrin sipas nivelit të cekur në nënparagrafët 2.3.2. dhe 2.3.3. të këtij paragrafi;

2.3.2. nëse transferi kryhet në bazë të një urdhërpagese të gabuar të përshkruar në nënparagrafët 2.1. apo 2.2. të këtij paragrafi, dërguesi nuk është i obliguar që të paguaj urdhrin dhe institucioni pranues ka të drejtë që të tërheq nga i paguari çdo shumë që i është paguar të të paguarit;

2.3.3. nëse transferi kryhet në bazë të një urdhërpagese të përshkruar në nënparagrafin 2.2. të këtij paragrafi, dërguesi nuk është i obliguar që të paguaj urdhrin në nivelin që shuma e pranuar nga i paguari është më e madhe se shuma që ka pasur për qëllim dërguesi. Në atë rast, institucioni pranues ka të drejtë që të tërheq nga i paguari shumën e pranuar shtesë.

3. Nëse, (1) dërguesi i një urdhërpagese të gabuar të përshkruar në paragrafin 2. të këtij neni nuk është i obliguar që të paguaj tërë ose një pjesë të urdhrin, dhe (2) dërguesi pranon një njoftim nga institucioni pranues se urdhri është pranuar nga institucioni apo se llogaria e dërguesit është debituar në lidhje me urdhrin, dërguesi ka për detyrë që të ushtrijë kujdes të zakonshëm, në bazë të informacioneve që janë në dispozicion të dërguesit, për të zbuluar gabimin në lidhje me urdhrin dhe ta njoftojë institucionin për faktet relevante brenda një kohe të arsyeshme, që nuk kalon dyzet e pesë (45) ditë, pas pranimin të njoftimit të institucionit nga ana e dërguesit. Nëse banka dëshmon se dërguesi ka dështuar ta kryejë atë detyrë, dërguesi është përgjegjës ndaj institucionit për humbjen që institucioni dëshmon se ishte shkaktuar si rezultat i dështimit, por detyrimi i dërguesit nuk mund të tejkalojë shumën e urdhrin të dërguesit.

Neni 35 **Njoftimi për humbje, vjedhje apo shfrytëzim të paautorizuar**

1. Institucion i pagesave siguron mjete efektive dhe të përshtatshëm me anë të së cilit klienti mund të njoftojë për ndonjë humbje, keqpërdorim, vjedhje apo shfrytëzim të paautorizuar të një karteje apo të pajisjeve tjera elektronike apo shkelje të kodit të sigurisë së qasjes.

2. Institucioni i pagesave siguron procedurat për konfirmim të pranimit të njoftimeve, duke përfshirë njoftimin nëpërmjet telefonit nga ana e një klienti për ndonjë humbje, keqpërdorim, vjedhje apo shfrytëzim të paautorizuar të një karteje apo të pajisjeve tjera elektronike apo shkelje të kodit të sigurisë së qasjes.

3. Konfirmimi nuk ka nevojë që të jetë me shkrim më kusht që institucioni të ketë mjete me anë të së cilave klienti mund të verifikojë se ai e ka bërë njoftimin dhe se kur është bërë një njoftim i tillë.

Neni 36

Përgjegjësia në rastet e mosfunksionimit të sistemit apo pajisjeve

1. Institucioni i pagesave është përgjegjës ndaj klientit të tij:

1.1. për dëmin e shkaktuar nga dështimi i sistemit të transferit elektronik të fondeve apo pajisjeve për kryerjen e një transaksioni të pranuar nga një terminal, në përputhje me udhëzimin e klientit; apo

1.2. për gabimin në llogaritjen kompjuterike apo mbajtjen e librave të bërë nga institucioni.

2. Institucioni i pagesave e njofton menjëherë klientin nëpërmjet:

2.1. njoftimit në bankomate, pika të shitjes apo në terminale tjera elektronike;

2.2. njoftimit në zyrat e tij; apo

2.3. ndonjë mënyre tjetër që ai e konsideron të përshtatshme, nëse është në dijeni se sistemi apo pajisjet për kryerjen e transfereve të fondeve nuk janë në dispozicion për shfrytëzim apo kur ato nuk funksionojnë si duhet.

3. Institucioni i pagesave e njofton menjëherë klientin për ndonjë dështim të ndodhur në ekzekutimin e urdhërpagesës për çdo mosfunksionim paraprak të pavërejtur të sistemit.

4. Kur klienti është dashur të jetë në dijeni se sistemi apo pajisjet nuk ishin në dispozicion për shfrytëzim apo nuk funksiononin siç duhet, përgjegjësitë e institucionit janë të kufizuara në korrigjimin e çdo gabimi në llogarinë e klientit, dhe në kompensimin e çdo ngarkese apo pagese që klienti është ngarkuar për atë transaksion.

5. Pavarësisht asaj që është përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, institucioni i pagesave nuk është përgjegjës ndaj klientit të tij nëse dështimi për të kryer një transfer të fondeve ishte shkaktuar nga apo kishte rezultuar nga forca madhore apo rrethanat tjera jashtë kontrollit të tij, më kusht që institucioni të ketë ushtruar kujdes dhe vigjilencë të arsyeshme.

Neni 37

Siguria e depozitave në terminalin elektronik

1. Siguria e një depozite të pranuar në një terminal elektronik është përgjegjësi e institucionit që pranon depozitën, nga koha e përfundimit të transaksionit, varësisht nga verifikimi i shumës së depozituar.

2. Kur ekziston ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës së regjistruar si të depozituar në një terminal elektronik dhe shumës të regjistruar si të pranuar, institucioni e njofton klientin për ndryshimin në ditën e nesërme të punës dhe njofton për shumën aktual e cila është kredituar në llogarinë e klientit.

Neni 38
Detyra e klientëve për të njoftuar për gabimet

1. Klienti duhet ta njoftojë institucionin e tij të pagesave për çdo gabim në pasqyrën e tij të llogarisë apo për ndonjë transaksion të paautorizuar në lidhje me kartelën e tij apo kodin e sigurisë së qasjes.
2. Njoftimi bëhet më shkrim brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e nxjerrjes së pasqyrës së llogarisë.
3. Kur ekziston një ankesë nga klienti për transfer të paautorizuar të fondeve, institucionit duhet të dëshmojë që të tregojë se transferi i fondeve ishte autorizuar, i regjistruar saktësisht, i futur në llogari dhe nuk është ndikuar nga prishja teknike apo nga ndonjë mangësi tjetër.
4. Për qëllimet e këtij neni, gabimi në pasqyrën e llogarisë përfshinë:
 - 4.1. transferin e pasaktë në apo nga llogaria e klientit; apo
 - 4.2. shtimin apo heqjen në pasqyrën periodike të një transferi të fondeve që ndikon në llogarinë e klientit.

Neni 39
Detyrat tjera të klientit

1. Klienti nuk duhet që:
 - 1.1. në mënyrë direkte apo indirekte t'ia zbulojë ndonjë personi kodin e sigurisë së qasjes të kartelës së tij apo ndonjë pajisjeje tjetër elektronike të shfrytëzuar për të kryer transferet e fondeve apo të jap miratimin elektronik; apo
 - 1.2. dështojë në ndërmarrjen e kujdesit të arsyeshëm për ta mbajtur sekret kodin e sigurisë së qasjes dhe pajisjeve tjera elektronike.
2. Institucioni i pagesave lirohet nga çdo përgjegjësi nëse dëshmohet se klienti ka shkelur detyrën e caktuar në paragrafin 1. të këtij neni.
3. Klienti nuk është përgjegjës për dëmet që rezultojnë nga një transaksion i paautorizuar që ndodh pasi që ai të ketë njoftuar institucionin e pagesave se kartela e tij është humbur, keqpërdorur a vjedhur, apo se kodi i sigurisë së qasjes ose pajisjeve tjera elektronike që mundësojnë miratimin elektronik është shkelur.

Neni 40
Vonesa në njoftim

Kur klienti ka kontribuar në një dëm që rezulton nga një transaksion i paautorizuar duke u vonuar në dhënien e njoftimit për kartelën e humbur, të keqpërdorur apo për vjedhjen e kartelës, apo për dikë tjetër që e di kodin e sigurisë së qasjes së kartelës, klienti është përgjegjës për dëmin aktualë që ka ndodhur, përveç për atë pjesë të dëmit të pësuar në cilëndo ditë që tejkalon limitin e transaksionit ditor të kartelës, mjetit tjetër apo llogarisë.

Neni 41
Rrethanat kur klienti nuk është përgjegjës

1. Klienti nuk është përgjegjës për dëmin që:
 - 1.1. nuk i atribuohet apo për të cilin nuk ka kontribuar klienti;

1.2. shkaktohet nga sjellja mashtruese apo e pakujdesshme e zyrtarëve të apo agjentëve të emëruar nga:

1.2.1 institucioni;

1.2.2. kompanitë dhe institucionet tjera të përfshira në aranzhimet e rrjeteve; apo

1.2.3. tregtarët të cilat janë të lidhur me kartelën apo me sistemin tjetër të komunikimit.

1.3. ka të bëjë më një kartelë që është falsifikuar, është e gabuar, e skaduar, apo

1.4. ndodhë para se klienti të ketë pranuar kartelën e tij apo kodin e sigurisë së qasjes.

2. Në rast të lindjes së ndonjë kontesti lidhur me kartelën e klientit, konsiderohet se klienti nuk e ka pranuar kartelën, përveç nëse mund të dëshmohet ndryshe nga institucioni.

Neni 42 E drejta në kompensim

1. Paguesi ka të drejtë që të kompensohet nga institucioni i tij i pagesave për një transfer të autorizuar të fondeve të iniciuar nga apo nëpërmjet të të paguarit i cili tashmë është ekzekutuar, nëse plotësohen kushtet si në vijim:

1.1 .autorizimi nuk ka specifikuar shumën e saktë të transaksionit të pagesës kur është bërë autorizimi; dhe

1.2. shuma e pagesës e ka tejkaluar shumën që paguesi më arsye ka mundur ta presë duke marrë parasysh strukturën e mëparshme shpenzuese, kushtet në kontratën e tij kornizë dhe rrethanat relevante të rastit. Më kërkesë të institucionit të pagesave, paguesi ofron elemente faktike lidhur me kushtet e tilla.

2. Kompensimi përbëhet nga shuma e plotë e transferit të ekzekutuar. Megjithatë, paguesi dhe institucioni i tij i pagesave mund të pajtohen në kontratën kornizë se paguesi ka të drejtë kompensimi madje edhe nëse nuk plotësohen kushtet për kompensim në paragrafin 1. të këtij neni.

3. Në kontratën kornizë, paguesi dhe institucioni i tij financiar mund të pajtohen që paguesi të mos ketë të drejtë kompensimi në rast se ai ka dhënë miratimin e tij për të ekzekutuar transferin drejtpërsëdrejti në institucionin e tij të pagesave dhe, kur është e aplikueshme, informacionet rreth transferit të ardhshëm janë dhënë apo vënë në dispozicion të paguesit sipas mënyrës së dakorduar për së paku një (1) javë para datës së paraparë nga ana e institucionit të pagesave apo nga i paguari.

4. Paguesi mund të kërkojë kompensimin e referuar në paragrafin 1. të këtij neni për një transfer të autorizuar të iniciuar nga apo nëpërmjet të të paguarit për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditë nga data në të cilën fondet janë debituar.

5. Brenda dhjetë (10) ditëve pune nga pranimi i kërkesës për kompensim, institucioni i pagesave ose e kompenson shumën e plotë të transferit apo ofron një justifikim për refuzimin e kompensimit.

KREU IV DISPOZITAT E POSAÇME LIDHUR ME LLOGARITË BANKARE

Neni 43 Tërheqjet dhe pagesat nga llogaria

1. Varësisht nga kushtet e marrëveshjes, bilanci kreditor i cili ka mbulesë adekuate në një llogari mund të tërhiqet nga klienti ose të paguhet nga banka në përputhje me urdhërpagesën.

2. Paragrafi 1. i këtij neni nuk zbatohet në rastin kur bilanci i kredisë në një llogari i është nënshtruar sekuestrimit, konfiskimit apo ndonjë procesi të ngjashëm kreditor; kur llogaria bankare është mbyllur, është pezulluar ose është ngrirë dhe kur në kryerjen urdhërpagesave banka ka shkelur ligjin në fuqi.

Neni 44 Pasqyra e llogarisë

1. Banka u ofron klientëve të saj, sipas kërkesave të tyre pasqyrën e llogarisë, në të cilën shënohet çdo kreditim dhe debitim i regjistruar në llogari që nga dhënia e pasqyrës së fundit si dhe për bilancin përfundimtar të llogarisë.

2. Pasqyra e llogarisë mund të sigurohet përmes postës elektronike nëse klienti preferon kështu.

Neni 45 Sekreti i llogarisë

Banka ruan sekretin dhe nuk i zbulon të dhënat e llogarive të asnjë klienti, përveç rastit kur një gjë e tillë kërkohet me një urdhëresë gjyqësore, sipas ligjit në fuqi apo sipas autorizimit të shprehur të klientit.

Neni 46 Regjistri i llogarisë

1. Banka Qendrore mban një regjistër të vetëm të llogarive bankare në Republikën e Kosovës në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret e nxjerrura nga BQK.

2. Për qëllimet e paragrafit 1. të këtij neni, të gjitha bankat që operojnë në Republikën e Kosovës paraqesin dhe përditësojnë rregullisht të dhënat bazë të identifikimit të llogarive individuale që ato i mbajnë, siç përcaktohet me ligje dhe rregullore të BQK-së.

KREU V HETIMI DHE PROCEDURA E ZGJIDHJES

Neni 47 Ankesat dhe hetimi

1. Institucioni i pagesave duhet që:

1.1. të krijojë procedura të formalizuara për paraqitjen e ankesave nga ana e klientëve për çështjet e mbuluara nga kjo pjesë;

1.2. të krijojë procedura të përshtatshme për hetimin dhe zgjidhjen e çdo ankese të klientit; dhe

1.3. të përcaktojë në kushtet dhe rregullat standarde mjetet dhe procedurat për paraqitjen e ankesës.

2. Klienti kërkohet që t'ia zbulojë institucionit të pagesave të gjitha informacionet relevante lidhur me ankesën përveç kodit të tij të qasjes.

3. Institucioni i pagesave duhet, për aq sa është e mundshme, t'i zgjidh sa më shpejtë ankesat.

4. Vendimi i institucionit të pagesave në lidhje me një ankesë do të merret në bazë të të gjithat fakteve të vërtetuara relevante e jo në bazë të ndërhyrjeve të pambështetura në prova.

5. Kur një institucion i pagesave nuk është në gjendje që të zgjidh menjëherë një ankesë ashtu siç kërkohet sipas paragrafit 3. të këtij neni, ai e njofton menjëherë klientin për nevojën prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të zgjidhur ankesën.

6. Kur një institucion i pagesave nuk është në gjendje që të zgjidh ankesën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve, ai njofton klientin më shkrim për nevojën e vazhdimit të kohës e cila në asnjë rast nuk duhet të tejkalojë tridhjetë (30) ditë nga data e paraqitjes së ankesës.

7. Institucioni i pagesave e njofton shpejt klientin për rezultatin e hetimit, së bashku më arsyet e rezultatit pas përfundimit të hetimit.

8. Kur si rezultat i hetimit të një ankese, institucioni i pagesave zbulon se llogaria e klientit është kredituar apo debituar gabimisht, kur është e përshtatshme, ai menjëherë:

8.1. bën përshtatjen e llogarisë së klientit duke përfshirë interesin ose tarifat e aplikueshme nga institucioni i pagesave.

8.2. njofton më shkrim për përshtatjet e bëra në llogarinë e tij.

Neni 48

Detyra për ta njoftuar klientin lidhur me përgjegjësinë

1. Kur një institucion i pagesave është i mendimit se klienti është përgjegjës për dëmin që lind nga ndonjë humbje, keqpërdorim, vjedhje apo shfrytëzim i paautorizuar i kartelës apo shkelja e kodit të sigurisë:

1.1. institucioni i pagesave do t'i vë në dispozicion të klientit kopjet e çdo dokumenti apo provave tjera relevante për rezultatin e hetimit të tij, duke përfshirë informacionet nga evidenca e transaksioneve; dhe

1.2. institucioni i pagesave po ashtu do t'i referohet sistemeve të evidencës për të vërtetuar nëse ka pasur ndonjë keqfunksionim të sistemit apo të pajisjeve në kohën e transaksioneve, dhe e njofton klientin me shkrim për rezultatin e hetimit të tij.

2. Gjithmonë sigurohet se institucioni i pagesave nuk do të kërkohet që të paraqes ndonjë informacion që ka lidhje të drejtpërdrejtë në apo që do të ndikonte në sigurinë e institucionit të pagesave apo të sistemeve të tij.

Neni 49

Informacionet dhe këshilla për ankesë

1. Procedura e ankesës përmban informacione në lidhje me:

1.1. të drejtën e klientit për tu ankuar kundër rezultatit të ankesës së tij tek menaxhmenti i lartë; dhe

1.2. të drejtën e klientit për t'ia referuar ankesën Bankës Qendrore, nëse ai nuk është i kënaqur me rezultatin e ankesës së tij.

2. Institucioni e njofton klientin apo i vë në dispozicion të klientit informacionin nga paragrafi 1 të këtij neni.

Neni 50

Shënimet e ankesës

Institucioni mban shënime për ankesat dhe zgjidhjet e tyre, në mënyrë që të dhënat e përgjithshme për llojin, shpeshtësinë dhe zgjidhjen e ankesave të tilla të mund të vihen në dispozicion të Bankës Qendrore kur kërkohet.

Neni 51 Gjurmët për Auditim

Institucioni siguron se transferet e fondeve të tyre nxjerrin shënime të mjaftueshme që mundësojnë për të zbuluar, kontrolluar dhe në rast të ndodhjes së ndonjë gabimi për ta identifikuar dhe korrigjuar atë gabim.

Neni 52 Privatësia

1 .Institucioni siguron që të gjithat informacionet në lidhje me një transfer të fondeve të klientit të tij nuk do të zbulohen përveç nëse kjo lejohet me ligj.

2. Asnjë person tjetër përveç zyrtarit ose agjentit të emëruar nga institucioni që mban llogarinë, apo klienti, nuk mund të ketë qasje nëpërmjet një terminali elektronik në informacionet lidhur me transferin e fondeve, punët apo llogarinë e klientit.

3. Asnjë terminal elektronik nuk duhet të jetë në gjendje që të ofrojë ndonjë informacion lidhur me transferin e fondeve, punët apo llogarinë e klientit, përveç nëse:

3.1. terminali elektronik operohet nga një zyrtar i institucionit apo agjent i emëruar nga institucioni; apo

3.2. kërkesa për informacion paraprihet nga futja e kodit të saktë të qasjes apo kartelës së klientit.

4. Institucioni nuk duhet të ofrojë çdo informacion lidhur me transferin e fondeve apo çështjet e llogarisë së klientit përveç nëse informacionit jepet:

4.1. në përputhje me detyrën apo përgjegjësinë ligjore; apo

4.2. më pëlqimin e klientit.

5. Rregullat që rregullojnë operacionin e llogarive individuale do të zbatohen për transferet e fondeve në lidhje me zbulimin e informacioneve për palët e treta.

Neni 53 Heqja dorë nga të drejtat dhe mbrojtja më e madhe

1. Asnjë marrëveshje me shkrim ndërmjet klientit dhe institucionit të pagesave nuk mund të përmbajë ndonjë dispozitë që paraqet heqje dorë nga ndonjë e drejtë e akorduar apo shkak veprimi të krijuar sipas këtij ligji.

2. Asgjë në këtë ligj nuk parandalon ndonjë marrëveshje, e cila i jep klientit më shumë të drejtat shtesë, apo masa përmirësuese a mbrojtje më të madhe sesa ato të parapara në këtë ligj.

Neni 54 Kufizimi i posaçëm apo përjashtimi

Banka Qendrore ka kompetencë që të caktojë kufizime të posaçme apo të bëjë përjashtime për kategoritë e caktuara të instrumenteve të pagesave në lidhje me strukturën e tyre dhe efikasitetin me qëllim të mbrojtjes së shfrytëzuesit..

PJESA IV DISPOZITAT E NDRYSHME

Neni 55 Vlefshmëria e të dhënave elektronike

1. Pavarësisht në ndonjë ligj, rregullore a praktikë të zakonshme më anë të së cilave përndryshe ato mund të jenë të pranueshme në çdo gjykatë, informacionet lidhur me çdo transfer nëpërmjet një sistemi të cilat i përmban ndonjë dokument, printim kompjuterik, kopje e printuar, mikrofilm, disketë a "hard disk, apo ndonjë medie a formë tjetër elektronike pranohen si prova në lidhje me transferin në fjalë.

2. Imazhet fotografike siç janë filmi, mikrofilmi, mirokatalogët apo imazhet kompjuterike të dokumenteve origjinale siç janë çeqet ose instrumente tjera të pagesave, letrat më vlerë, certifikatat e depozitimit, librat e llogarive dhe letrat me vlerë të qeverisë janë të pranueshme si prova për çështjet apo transaksionet e instrumentit origjinal.

3. Udhëzimet e pagesave, mesazhet dhe transferet e fondeve që janë iniciuar, procesuar dhe ekzekutuar nëpërmjet mjeteve elektronike duke përfshirë nënshkrimet elektronike janë të pranueshme si prova për çështjet apo transaksionet e instrumentit origjinal.

4. Shënimet në librat e llogarive, librat e parave të gatshme dhe librat tjera të llogarive të ndonjë institucioni financiar, qoftë të mbajtura në mënyrë manual me dorëshkrim apo në mënyrë të kompjuterizuar janë prova të çështjeve, transaksioneve dhe llogarive të regjistruara nga drejtori, kryeshefi ekzekutiv, partneri, menaxheri apo ndonjë zyrtar tjetër i atij institucioni financiar apo si dëshmi se librat e tilla manuale apo të kompjuterizuara, librat e parave të gatshme dhe librat tjera të llogarive janë apo kanë qenë libra të zakonshëm të llogarive të institucionit financiar dhe se:

4.1. shënimet janë bërë gjatë rrjedhës së zakonshme dhe normale të veprimtarisë afariste; dhe

4.2. librat mbahen apo vijnë menjëherë nga mbajtja e institucionit financiar.

Neni 56 Dispozitat kalimtare

1. Bankat, institucionet financiare dhe të gjithat entitetet tjera ligjore përkatëse që ushtrojnë aktivitet në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligjit duhet ta përshtatin (1) organizmin, (2) administrimin, dhe (3) operacionet e tyre sipas kërkesave të këtij ligji brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Bankat, institucionet financiare dhe të gjithat subjektet tjera ligjore relevante (1) organizmi, (2) administrimi, apo (3) operacionet e të cilave nuk janë në përputhje më një a më shumë prej aspekteve materiale të kërkesave të ndonjë rregulloreje apo udhëzimi që lëshohet nga Banka Qendrore sipas këtij ligji, duhet t'iu përmbahen kërkesave të një mase të tillë brenda periudhës kohore që do të specifikohet apo do të ndërpriten.

Neni 57

Ligjet e pazbatueshme

Të gjitha ligjet, rregulloret, udhëzimet, urdhrat apo përjashtimet nga ligjet, rregulloret apo udhëzimet ekzistuese që nuk janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, janë të pazbatueshme për sa i përket çështjeve të parapara në këtë ligj.

Neni 58 Dispozita shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Rregullorja nr. 2001/26 e UNMIK-ut mbi Transaksionet e Pagesave.

Neni 59 Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-155
04 prill 2013**

Shpallur me dekretin Nr.DL-016-2013, datë 24.04.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.